

**Mungesa nga
shkolla**

**Pushime gjatë
vitit shkollor**



**London Borough
of Hounslow**

Pushim gjatë vitit shkollor!

Ka 190 ditë shkollore në vit dhe pritshmëria e shkollave dhe e Autoritetit Vendor është që fëmijët në moshë të detyrueshme shkollimi, të cilët janë të regjistruar në një shkollë, të ndjekin mësimin çdo ditë që shkolla është e hapur.

Kjo do të thotë se mbeten 175 ditë që mund t'i përdorni për takime, festa, ditëlindje, aktivitete dhe pushime familjare.

Mund të ketë raste të pranueshme kur një fëmijë nuk mund të ndjekë shkollën, si për shembull kur është shumë i sëmurë ose ka një takim mjekësor që nuk mund të zhvillohet jashtë orarit shkollor.

Të nxjerrësh një fëmijë nga shkolla gjatë vitit shkollor për pushime nuk është arsye e pranueshme për mungesë në shkollë. Prindi/kujdestari nuk ka të drejtë automatike për të marrë fëmijën nga shkolla gjatë kohës së vitit shkollor për pushime.

Ka një lidhje të qartë statistikore midis ndjekjes së parregullt të shkollës dhe rezultateve arsimore. Mungesa në shkollë ka një efekt shqetësues si për nxënësin ashtu edhe për gjithë klasën. Çdo ditë mungese nga shkolla, femija humbet mësimin e vlefshëm dhe kohën e planifikuar të mësimdhënies, dhe rutina e tij e përditshme ndërpritet. Kjo mund të çojë në rrezikun e mbetjes mbrapa në aspektin akademik, rezultate të dobëta dhe izolim shoqëror. Pjesëmarrja e rregullt në shkollë është thelbësore që nxënësit të përfitojnë sa më shumë nga përvoja e tyre shkollore, përfshirë arritjet, mirëqenien dhe mundësitë e tyre të mëvonshme në jetë. Nxënësit me arritjet më të larta në fund të ciklit kyç 2 dhe ciklit kyç 4 kanë norma më të larta të ndjekjes së shkollës gjatë gjithë ciklit krahasuar me ata me arritjet më të ulëta.

Pjesëmarrja e rregullt në shkollë është e rëndësishme për të gjitha aspektet e jetës së një fëmije, jo vetëm sepse është e përcaktuar me ligj. Prindërit/kujdestarët, stafi i shkollës, Autoritetet Vendore dhe të gjitha shërbimet e tjera duhet të punojnë së bashku për të përmirësuar pjesëmarrjen në shkollë, për të reduktuar mungesat e paautorizuara dhe për të siguruar që çdo fëmijë të përfitojë arsim të plotë sipas të drejtës që i takon.

Paralajmërim

Rregulloret përcaktojnë se Drejtori i shkollës nuk mund të japë leje mungese për një nxënës përveç rasteve kur është bërë një kërkesë paraprakisht dhe drejtori e konsideron se ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme në lidhje me atë kërkesë.

Një rrethanë e jashtëzakonshme është një ngjarje e pashmangshme, si një emergjencë, që zakonisht nuk mund të planifikohet paraprakisht. Departamenti për Edukimin (DfE) nuk e konsideron si rrethanë të jashtëzakonshme dëshirën apo nevojën për pushime ose mungesë me qëllim argëtimi dhe çlodhjeje.

Çdo kërkesë do të shqyrtohet nga Drejtori i shkollës rast pas rasti; megjithatë, Autoriteti Vendor këshillon fuqimisht që Drejtorët të mos japin leje për mungesë gjatë vitit shkollor, pasi mungesat duhet të mbahen në nivelin më të ulët të mundshëm.

Drejtori i shkollës do t'i shkruajë prindit/kujdestarit duke e paralajmëruar se leja nuk është miratuar. Të gjitha periudhat e mungesës që nuk janë miratuar nga Drejtori dhe që prapëseparapë realizohen, do të regjistrohen si mungesa të paautorizuara dhe do të ndikojnë në nivelin e pjesëmarrjes së fëmijës në shkollë.

Nëse një fëmijë nuk kthehet në shkollë në datën e rënë dakord, mund të rrezikojë të hiqet nga regjistri i shkollës. Prindi/kujdestari do të duhet të aplikojë sërish pas kthimit. Nuk ka asnjë garanci që fëmija do të përfitojë vend në të njëjtën shkollë.

Shkollat do të raportojnë të gjitha rastet e mungesave të paautorizuara gjatë vitit shkollor te Shërbimi i Mbështetjes për Pjesëmarrje në Shkollë (SASS), ku do të kryhen verifikime për të identifikuar nëse ka një histori ose modele të mungesave të paautorizuara. Një Letër Paralajmërimi për Gjobë do të lëshohet për periudhën e parë të mungesës së paautorizuar. Letra paralajmëron për rrezikun e lëshimit të një Gjobe Administrative ose ndjekjes penale nëse ndodhin sërish mungesa ose pushime të paautorizuara. Shpresohet që paralajmërimi do të dekurajojë çdo periudhë të mëtejshme mungese dhe do të shmangë nevojën për veprime të tjera.

Ligji

Ligji përcakton se të gjithë prindërit/kujdestarët kanë detyrimin ligjor për të siguruar që fëmija i tyre të marrë një arsim me kohë të plotë që përputhet me nevojat e tij (për shembull, nëse ka nevoja të veçanta arsimore).

Fëmijët duhet të marrin arsim gjatë gjithë periudhës së moshës së detyrueshme shkollore, nga fillimi i tremujorit pas ditëlindjes së tyre të 5-të, deri të premten e fundit të qershorit të vitit shkollor në të cilin mbushin 16 vjeç.

Ju mund të zgjidhni t'i edukoni vetë (Arsimim në Shtëpi me Zgjedhje - EHE), ose ta regjistroni fëmijën në një shkollë, në të dyja rastet, udhëzimet janë të qarta: çdo fëmijë ka të drejtë të marrë një arsim me kohë të plotë. Prindi/kujdestari mund të ndiqet penalisht nëse nuk siguron që fëmija po merr këtë arsim.

Fjala 'rregullisht' në lidhje me pjesëmarrjen në shkollë ka kuptimin e përcaktuar nga rregullat e shkollës, që do të thotë se fëmija pritët të ndjekë shkollën çdo ditë që ajo është e hapur, përveç rasteve kur është dhënë leje mungese nga drejtori.

Të gjitha shkollat janë të detyruara të kenë një Politikë për Pjesëmarrjen në Shkollë, e cila publikohet në faqen e tyre zyrtare dhe përcakton qartë pritshmëritë e shkollës, procedurat dhe nevojën për të mbajtur mungesat në nivelin minimal të mundshëm.

Pjesëmarrja e rregullt dhe në kohë në shkollë është një kërkesë ligjore dhe është thelbësore për të maksimizuar mundësitë arsimore të nxënësve.

Shkollat janë përgjegjëse për të monitoruar të gjitha mungesat, me fokus të veçantë te nxënësit që mungojnë 10% ose më shumë të shkollës, këta klasifikohen si mungues të vazhdueshëm, ndërsa ata që mungojnë 50% ose më shumë klasifikohen si mungues të rëndë. Kështu siç përcaktohet nga Departamenti për Edukimin dhe Aftësitë (DfE).

Gjobat Administrative

Gjobat Administrative jepen në përputhje me Rregulloren për Arsimin (Gjobat Administrative) (Angli) 2007, të ndryshuar, dhe pasqyrojnë ndryshimet ligjore të prezantuara në vitin 2024, të përcaktuara në Kornizën Kombëtare të DfE dhe Kodin Vendor të Sjelljes së Bashkisë së Londrës. Qëllimi i gjobave administrative është të shmangin nevojën për çështje gjyqësore.

Një gjobë mund t'i jepet secilit prind që mban përgjegjësi ligjore për shkeljen ose shkeljet e bëra. Ato jepen prindit/ëve që kanë lejuar mungesën (pavarësisht se cili prind ka bërë kërkesën për leje mungese).

Gjobat Administrative për një shkelje të parë janë £160 për çdo prind për çdo fëmijë. Prindërit kanë në dispozicion 28 ditë për të paguar shumën e plotë. Nëse paguhen brenda 21 ditëve, gjoba ulet në £80 për çdo prind për çdo fëmijë. Gjobat për një shkelje të dytë janë £160 për çdo prind për çdo fëmijë. Prindërit kanë në dispozicion 28 ditë për të paguar shumën e plotë.

Ekziston një kufi kombëtar prej maksimumi 2 Gjobash Administrative që mund t'i jepen një prindi për të njëjtin fëmijë brenda një periudhe 3-vjeçare lëvizëse. Pasi të kenë kaluar 3 vite nga data e gjobës së parë, një gjobë tjetër mund të jepet nëse konsiderohet e përshtatshme, por në shumicën e rasteve ajo nuk do të jetë mjete më efektiv për të ndryshuar një model sjelljeje që mund të jetë bërë tashmë i ngulitur.

Nuk ka të drejtë apelimi ndaj një Gjobe Administrative.

Në rastet kur pragu kombëtar arrihet për herë të tretë (ose më shumë) brenda një periudhe 3-vjeçare, do të merren parasysh veprime alternative. Kjo shpesh përfshin ndjekje penale.

Sipas legjislacionit ekzistues, prindërit/kujdestarët kryejnë një veprë penale kur nuk arrijnë të sigurojnë pjesëmarrjen e rregullt të fëmijës/fëmijëve të tyre në shkollë. Veprimet ligjore do të ndërmerren në bazë të nenit 444(1) dhe 444(1A) të Ligjit për Arsimin 1996 (Education Act 1996).

Në rastet kur prindërit/kujdestarët shpallen fajtorë, ata do të marrin një dënim penal, i cili duhet të deklarohet te punëdhënësi, si dhe do të jenë të ekspozuar ndaj gjoba shumë më të larta, urdhra shërbimi në komunitet, urdhra rehabilitimi ose mbikëqyrje nga shërbimet e provës. Kjo mund të ndikojë në punësimin tuaj aktual dhe të ardhshëm.

Nëse keni nevojë për këshilla, ju lutemi kontaktoni:

Shërbimin e Mbështetjes për Pjesëmarrjen në Shkollë

SASS Duty 0208583 2622

(08:30am – 4:30pm)

SASSDuty@hounslow.gov.uk

**Hounslow House
7 Bath Road
Hounslow
TW3 3EB**



**London Borough
of Hounslow**